REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

KOMITETI PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

# Plani Vjetor i punës për vitin 2025

Janar, 2025

Kryesues i Komitetit, Imran Haziri

**Roli i Komitetit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në Vendimmarrje**

Komiteti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit luan një rol thelbësor në procesin vendimmarrës të Kuvendit Komunal, duke shërbyer si urë lidhëse ndërmjet drejtorive komunale dhe këshilltarëve komunal. Ky trup ndihmon në analizimin, diskutimin dhe vlerësimin e çështjeve që lidhen me planifikimin urban dhe mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar që vendimet që merren të jenë sa më të drejta dhe të bazuara në interesin publik.

Në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Urbanizmit, komiteti:

1. Shqyrton planet zhvillimore dhe propozimet e projekteve infrastrukturore për të siguruar që ato janë në përputhje me legjislacionin dhe interesat afatgjata të qytetarëve.

2. Jep rekomandime për zgjidhje të qëndrueshme dhe të balancuara që respektojnë mjedisin, kulturën dhe nevojat zhvillimore të komunitetit.

3. Siguron transparencë dhe përfshirje të palëve të interesuara në proceset e planifikimit urban, duke krijuar hapësirë për diskutim dhe përmirësime.

4. Monitoron zbatimin e planeve urbanistike dhe projekteve për të garantuar që ato realizohen sipas standardeve dhe objektivave të përcaktuara.

Përmes këtij roli, komiteti mbështet këshilltarët komunal në krijimin e një balance ndërmjet zhvillimit urban dhe ruajtjes së mjedisit, duke ndihmuar që vendimet të jenë gjithëpërfshirëse, të drejta dhe të qëndrueshme. Ky bashkëpunim është kyç për të siguruar një zhvillim të harmonizuar që reflekton nevojat dhe aspiratat e qytetarëve.

**Objektivat dhe aktivitet për vitin 2025**

| **Aktiviteti** | **Afati kohor i zbatimit** | **Komente** |
|---|---|---|
| • Miratimi i Planit te Punes per vitin kalendarik 2025 dhe Miratimi i Raporti te punes per vitin 2024.<br>• Shqyrtimi i kerkesave te ndryshme nga qytetaret. | Janar | |
| • Kompenzimi i antareve të komitetit për planifikim urban dhe mbrojte të ambientit.<br>• Shqyrtimi i kërkesave nga qytetaret. | Shkurt | |
| • Raporti vjetor i vitit 2024 nga Drejtoria e Urbanizmit Planifikimit dhe Mbrojtje te Mjedisit<br>• Shqyrtimi i kërkesave nga qytetaret | Mars | |
| | Prill | |
| • Raporti 3 mujoresh i Drejtorise se Urbanizmit,Planifikimit dhe Mbrojtjes se Mjedisit. | Maj | |
| • Shqyrtimi i kërkesave nga qytetaret<br>• Takim me shoqaten e Inxh dhe Ark të Komunes së Gjilanit | Qershor | |
| • Takim me investitoret e Komunes<br>Shqyrtimi i kërkesave nga qytetaret | Korrik | |
| | Gusht | |
| • Raporti 6 mujoresh i vitit 2025 nga Drejtoria e Urbanizmit Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit | Shtator | |

| | | |
|---|---|---|
| • Shqyrtimi i kërkesave nga qytetaret<br><br>• Shqyrtimi i kërkesave nga qytetaret | Tetor | |
| • Shqyrtimi i kërkesave nga qytetaret | Nentor | |
| | Dhjetor | |

Të nderuar asambleistë,

Dëshirojmë t'ju njoftojmë se, në vitin 2025, Komiteti ynë ka planifikuar të mbajë **9 takime**. Takimet do të mbahen në përputhje me planin dhe do të trajtohen çështje të rëndësishme për zhvillimin e komunitetit dhe avancimin e projekteve të miratuara.

Kryesues i Komitetit, Imran Haziri